



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.317, datë:29.08.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit Nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70 paragrafi 70.1 pika b) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Vaxhid Rexhepaj, Zyrtar Autorizues për Projektin: "Ndërtimi i Trafostacionit me SN – 400 kVA".**
2. Zyrтари Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrтари Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t'i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrтари Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrтари Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrтари Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrтари Autorizues **z. Vaxhid Rexhepaj**, për Projektin: **"Ndërtimi i Trafostacionit me SN – 400 kVA"**.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Vaxhid Rexhepaj; dhe
- QSHQ - Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTTARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Nr. 02 Br. 23889
Nr. i faq. 1 Data: 01/09
Br. str. Datum: 2025
KAMENICË/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.316, datë:29.08.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, Kontrata Sh.02.Nr.22879 e datës 21.08.2025, nenit 70, paragrafi 70.1 shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxheres së kontratës dhe të mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të menaxheres së kontratës

1. Caktohet menaxherja e kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxheres së kontratës me titull: **"Participimi me donatorë – Parku i aventurave – ritenderim"**, me numër të kontratës **KM653-24-9294-5-2-1**, si në vijim:
 - 1.1. **Znj. Vlonë Matoshi** (Konsulente, Drejtorja për Investime Kapitale), **CAKTOHET** menaxhere e kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 **Znj. Amire Ismajli** (Konsulente, Drejtorja për Investime Kapitale), **CAKTOHET** mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e menaxheres së kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxherja e kontratës dhe mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e menaxheres së kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe manualët për përdorim të modulit për menaxhim të kontratës.
3. Të dërgohet raport i rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- znj. Vlonë Matoshi (Konsulente, Drejtorja për Investime Kapitale);
- znj. Amire Ismajli (Konsulente, Drejtorja për Investime Kapitale);
- QSHQ-arkivi.



Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETIT
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 24070
Nr. i faq. 1 Data: 02/09
Br. str. KAMENICËJA 2025

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.nr.318, datë:01.09.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 22 të Ligjit nr.04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr.05/L-068 dhe Ligjin nr.05/L-092 për Prokurimin Publik si dhe nenit 10 paragrafi 10.1 i rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 2, paragrafi 2.2, nënparagrafi 2.2.4 në Memorandumin për Bashkëpunim Sh.02.Nr.20372 të datës 30.07.2025 i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunes së Kamenicës për bashkëpunimin, financimin dhe zbatimin e projektit: “Shërbime për zhvillimin e dokumentacionit teknik”, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **CAKTOHET, z. Vaxhid Rexhepaj**, Zyrtar Autorizues, në Memorandumin për Bashkëpunim i lidhur ndërmjet Ministrisë Së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunes së Kamenicës për bashkëpunimin, financimin dhe zbatimin e Projektit: **”Shërbime për zhvillimin e dokumentacionit teknik”**.
2. Zyrtari Autorizues nga pika (1) një e këtij Vendimi nuk e autorizon Zyrtarin e Prokurimit që të inicioj aktivitetin e propozuar të prokurimit para se ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) i autoritetit kontraktues t’i ketë dorëzuar Zyrtarit autorizues Deklaratën përkatëse të nevojave dhe vendosshmërisë për disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) dhe ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) i autoritetit kontraktues.
3. Pas konstatimit të përmbushjes së kushteve të parapara sipas pikës (2) dy të këtij Vendimi, Zyrtari Autorizues e autorizon iniciimin e aktivitetit të prokurimit përmes dorëzimit Zyrtarit të Prokurimit të një udhëzimi me shkrim për iniciimin e aktivitetit të prokurimit së bashku me një kopje të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve të nënshkruara.
4. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Zyrtari Autorizues **z. Vaxhid Rexhepaj**, për Projektin: **”Shërbime për zhvillimin e dokumentacionit teknik”**.
5. Bashkëngjitur këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit Sh.02.Nr.20372 të datës 30.07.2025 i lidhur ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunes së Kamenicës për bashkëpunimin, financimin dhe zbatimin e projektit: “Shërbime për zhvillimin e dokumentacionit teknik”.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari Komunës.

Vendimi t’i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Vaxhid Rexhepaj; dhe
- Q.SH.Q - Arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Ministria e Kulturës, Rinisë Dhe Sportit

REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNITETI KOMUNAL
QENDRA PËR SHËRBIMET
CENTAR ZA USLUGE GRADANA

Sh. 02 Nr. 20372
U. Br. KAMENICEJA 2025

Nr. llog. 05 Data: 30/07/2025
Br. str. 3036/2025
31/07/2025



Komuna e Kamenicës

MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM

LIDHUR NDËRMJET

MINISTRISË SË KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

DHE

KOMUNES SË KAMENICËS

Palët nënshkruese

1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, (në tekstin e mëtejshëm MKRS); dhe
2. Komuna e Kamenicës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejshëm Komuna e Kamenicës).

Neni I Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi për Bashkëpunim është krijimi i kornizës për bashkëpunimin, financimin dhe zbatimin e projektit: "Shërbime për zhvillimin e dokumentacionit teknik", që përfshin;
 - 1.1. Dokumentimin dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese,
 - 1.2. Hartimin e projektit ideor, dhe

- 1.3. Hartimin e projektit të hollësishëm (zbatues/kryesor, të ndërtimit), të arkitekturës dhe të inxhinierisë për renovimin e Stadiumit të Qytetit në Kamenicë.

Neni 2 **Obligimet e Palëve**

- 2.1 **Ministria e Kulturës, Rinisë Dhe Sportit merr përsipër përmbushjen e obligimeve si në vijim:**

- 2.1.1. Sigurimin e mjeteve financiare, në shumën prej 25,000.00 € (njëzet e pesë mijë euro), për vitin 2025, përmes kodit të projektit: 12424, me titull: Renovimi i stadimeve ekzistuese të futbollit në qendrat regjionale, të Ligjit nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, për financimin e zbatimit të projektit: "Shërbime për zhvillimin e dokumentacionit teknik – të dokumentimit dhe të vlerësimit të gjendjes ekzistuese, të hartimit të projektit ideor dhe të hartimit të projektit të hollësishëm (zbatues/kryesor, të ndërtimit) të arkitekturës dhe të inxhinierisë për renovimin e Stadiumit të Qytetit në Kamenicë".
- 2.1.2. Vëzhgimin e zbatimit të kontratës/projektit të përcaktuar në paragrafin 2.1.1., në baza të rregullta periodike, gjithnjë në bashkërendim me zyrtarët/mekanizmat përgjegjës për menaxhimin e kontratës/projektit të emëruar nga Komuna sipas paragrafit 2.2.4., përmes emërimit të zyrtarëve/mekanizmave përgjegjës për vëzhgimin e menaxhimit të kontratave/projekteve, me vendim të prerë.
- 2.1.3. Vëzhgimin e kontrollit të cilësisë gjithëpërfshirëse gjatë zbatimit të kontratës/projektit të përcaktuar në paragrafin 2.1.1., gjithnjë në bashkërendim me zyrtarët/mekanizmat përgjegjës për mbikëqyrjen teknike të emëruar nga Komuna sipas paragrafit 2.2.5., përmes emërimit të zyrtarëve/mekanizmave përgjegjës për vëzhgimin e mbikëqyrjes teknike, me vendim të prerë.
- 2.1.4. Ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj "Ofruesit të shërbimeve", në shumën e përcaktuar me paragrafin 2.1.1., pas pranimit të dokumentacionit, të miratuar dhe të vërtetuar, të menaxhimit të kontratës/projektit dhe të mbikëqyrjes teknike, nga paragrafët 2.2.4. dhe 2.2.5., duke përfshirë: (a) raportin teknik përfundimtar, origjinalin e situatës së shërbimeve të përfunduara dhe faturën përkatëse; (b) kopjen e kontratës, të para-masës dhe të para-llogarisë dhe të gjitha pjesëve tjera përbërëse të kontratës; (c) kopjen e dokumentacionit teknik – në formatin digjital dhe të shtypur; dhe (d) origjinalin e shkresës përcjellëse për ekzekutimin e detyrimeve financiare në shumën e përcaktuar me paragrafin 2.1.1., nga Kryetari i Komunës për MKRS.
- 2.1.5. Sigurimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit me Komunën përgjatë përmbushjes së obligimeve të marra përsipër, përkatësisht përgjatë të gjitha proceseve në funksion të arritjes së qëllimit të këtij Memorandumi, përmes emërimit të zyrtarit përgjegjës ndërlidhës, me vendim të prerë.

- 2.2 **Komuna e Kamenicës merr përsipër përmbushjen e obligimeve si në vijim:**

- 2.2.1. Hartimin e dokumentacionit të kërkesës, udhëheqjen e procedurës së prokurimit dhe të kontraktimit, lidhur me zbatimin e projektit të përcaktuar në paragrafin 2.1.1., si dhe ndarjen formale të dokumentacionit të kërkesës, të procedurës së prokurimit, të kontratës dhe të planit për menaxhimin e kontratës, të miratuar dhe të vërtetuar, me MKRS.
- 2.2.2. Sigurimin e të gjitha pëlqimeve dhe/ose lejeve të zbatueshme, në përgjegjësinë e Komunës dhe të institucioneve të tjera, për zbatimin e projektit të përcaktuar në paragrafin 2.1.1., si dhe dorëzimin e kopjeve përkatëse në MKRS, para inicimit të procedurave të prokurimit.
- 2.2.3. Sigurimin e të gjitha pëlqimeve dhe/ose lejeve të zbatueshme, në përgjegjësinë e ndërmarrjeve publike përgjegjëse për sistemet e furnizimit me ujë, largimin e ujërave të zeza dhe atmosferike, për sistemet e furnizimit me energji elektrike, si dhe për sistemet e telekomunikacionit, për zbatimin e projektit të përcaktuar në paragrafin 2.1.1., si dhe dorëzimin e kopjeve përkatëse në MKRS, para inicimit të procedurave të prokurimit.
- 2.2.4. Udhëheqjen e zbatimit të kontratës/projektit të përcaktuar në paragrafin 2.1.1., përmes emërimit të zyrtarëve/mekanizmave përgjegjës për mbikëqyrjen e menaxhimit të kontratës/projektit dhe për menaxhimin e kontratës/projektit, me vendim të prerë; si dhe ndarjen formale të dokumentacionit, të miratuar dhe të vërtetuar, të menaxhimit të kontratës/projektit, me MKRS.
- 2.2.5. Udhëheqjen e kontrollit të cilësisë gjithëpërfshirëse gjatë zbatimit të kontratës/projektit të përcaktuar në paragrafin 2.1.1., përmes emërimit të zyrtarëve/mekanizmave përgjegjës për mbikëqyrjen teknike, me vendim të prerë; si dhe ndarjen formale të dokumentacionit, të miratuar dhe të vërtetuar, të mbikëqyrjes teknike, me MKRS.
- 2.2.6. Dorëzimin e dokumentacionit, të miratuar dhe të vërtetuar, të menaxhimit të kontratës/projektit dhe të mbikëqyrjes teknike, nga paragrafët 2.2.4. dhe 2.2.5., duke përfshirë: (a) raportin teknik përfundimtar, origjinalin e situatës së shërbimeve të përfunduara dhe faturën përkatëse; (b) kopjen e kontratës, të para-masës dhe të parallogarisë dhe të gjitha pjesëve tjera përbërëse të kontratës; (c) kopjen e dokumentacionit teknik – në formatin digjital dhe të shtypur; dhe (d) origjinalin e shkresës përcjellëse për ekzekutimin e detyrimeve financiare ndaj "Ofruesit të shërbimeve", në shumën e përcaktuar me paragrafin 2.1.1., nga Kryetari i Komunës.
- 2.2.7. Sigurimin e gjithë dokumentacionit tjetër të nevojshëm – ligjor, financiar dhe teknik, në bazë të kërkesës nga MKRS, në funksion dhe në mbështetje të përmbushjes së qëllimit të këtij Memorandumi.
- 2.2.8. Sigurimin e bashkëpunimit dhe bashkërendimit me MKRS përgjatë përmbushjes së obligimeve të marra përsipër, përkatësisht përgjatë të gjitha proceseve në funksion të arritjes së qëllimit të këtij Memorandumi, përmes emërimit të zyrtarit përgjegjës ndërlidhës, me vendim të prerë.

Neni 3

Zbatimi i Memorandumit

- 3.1. Palët zotohen t'i zbatojnë obligimet e marra përsipër, përmes këtij Memorandumi, në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- 3.2. Palët përcjellin dhe mbështesin zbatimin e Memorandumit dhe udhëzojnë me kohë për veprimet që duhet të ndërmerren deri në arritjen e qëllimit.
- 3.3. Afati përfundimtar për arritjen e qëllimit të këtij Memorandumi është viti 2025.

Neni 4

Ndryshimet dhe ndërprerja e Memorandumit

- 4.1. Ndërprerja e Memorandumit bëhet me marrëveshje ndërmjet Palëve.
- 4.2. Në rast se zbatimi i Memorandumit duhet të ndërpritet për shkak të ndodhjeve të fuqisë mbinatyrore (vis major) dhe rrethanave tjera të paparashikuara, Palët do të vendosin bashkërisht dhe në konsultim me palët tjera relevante për veprimet që duhet të ndërmerren.

Neni 5

Amandamentimi

Ky Memorandum mund të ndryshohet apo plotësohet në bazë të një marrëveshje me shkrim ndërmjet Palëve. Përveç kësaj, çfarëdo aspekti apo kushti i caktuar që nuk është theksuar në këtë Memorandum, për të cilat Palët do të pajtohen për të hyrë në bashkëpunim në të ardhmen, apo në një amendament të këtij Memorandumi, të nënshkruar nga Palët e kësaj marrëveshje do të konsiderohen si të integruara në këtë Memorandum.

Neni 6

Zgjidhja në rast të mosmarrëveshjeve

Palët do të përpigën që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me bisedime; nëse nuk mund të arrijnë mirëkuptim, atëherë, në rast mosmarrëveshjeje, kompetentë për zgjidhjen e saj është Gjykata Themelore në Prishtinë, e cila ka kompetencë të zgjidhë rastet e tilla.

Neni 7

Kopjet dhe gjuha e Memorandumit për Bashkëpunim



Ky Memorandum është përpiluar në gjuhën shqipe dhe në dy (2) origjinale, përkatësisht nga një (1) origjinal për secilën Palë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Palëti.


Bislim BISLIMI

Secretar i Përgjithshëm,
Ministria e Kulturës, Rinisë
dhe Sportit

Kadri RAHIMAJ


Kryetar,
Komuna e Kamenicës

Nënshkruar më / / 2025, në Prishtinë



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.319, datë:02.09.2025

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, Ligjin Nr.08/L-302 për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (BZHKE) për Projektin “Banimi Social Adekuat” me Marrëveshjen Kornizë të Kredisë ndërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës dhe Kosovës, si dhe Memorandumin e Mirëkuptimit në mes MMPHI dhe Komunës së Kamenicës për Projektin e Banimit Social Adekuat, duke marrë parasysh nevojën për organizim, implementimin dhe menaxhim të efektshëm të Projektit përmes nën-projekteve për Banimin Social Adekuat në territorin e Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

Për themelimin e Komisionit Vlerësues për Shprehjen e Interesit – Aplikacionet – për nën-projektin ‘Renovimi / Rindërtimi i Shtëpive Private për Familjet apo Individët e Cenueshëm’, në kuadër të Projektit të Banimit Social Adekuat

Neni 1

Themelimi i Komisionit

1. Në kuadër të Komunës së Kamenicës, themelohet Komisioni Vlerësues për verifikim dhe vlerësim të Shprehjes së Interesit – Aplikacioneve – për nën-projektin ‘Renovimi/Rindërtimi i Shtëpive Private për Familjet apo Individët e Cenueshëm’, në kuadër të obligimeve të Komunës për përzgjedhjen pa diskriminim të Përfituesve Përfundimtar si një parim themelor i implementimin të Projektit të Banimit Social Adekuat përmes nën-projekteve.
2. Komisioni Vlerësues për verifikim dhe vlerësim të Shprehjes së Interesit – Aplikacioneve - do të funksionojë si organ kompetent komunal për pranimin, shqyrtimin, vlerësimin dhe verifikimin në terren të shprehjes së interesit për Renovim/Rindërtim të Shtëpive Private për Familjet apo Individët e Cenueshëm, duke bërë verifikimin e gjendjes ekonomike të familjeve/individëve dhe gjendjes aktuale-fizike të shtëpive për renovim/rindërtim, si nën-projekt në kuadër të Projektit të Banimit Social Adekuat.

Neni 2 Përbërja

1. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë të emëruar nga drejtoritë reprezentative të administratës komunale (Urbanizëm, Mirëqenie Sociale dhe Shëndetësi, Buxhet/Financa, Gjeodezi/Kadaster) dhe anëtar të Njësitit të Implementimit të Projektit:

- 1.1. Vjollcë Kryeziu (Drejtoria e Investimeve Kapitale);
- 1.2. Durim Biqkaj (Zyrtar për Banim Social);
- 1.3. Sylejman Kallaba (Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor);
- 1.4. Ramush Ismajli (Zyrtar nga DPKGJ); dhe
- 1.5. Edon Canaj (Drejtoria për Buxhet dhe Financa)

Neni 3 Detyrat dhe Përgjegjësitë

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisioni Vlerësues për verifikim dhe vlerësim të Shprehjes së Interesit – Aplikacioneve – për nën-projektin ‘Renovimi/Rindërtimi i Shtëpive Private për Familjet apo Individët e Cenueshëm’, janë:

1.1. Krijimi i bazës së të dhënave nga aplikacionet e pranuara, ku përfshihen numri i kërkesave për renovim dhe rindërtim të shtëpive private, numri i familjeve, individëve, struktura gjinore, gjendja e shtëpive, infrastrukturës dhe të dhënat tjera relevante të kërkuara për t’u bartur në **Formularin e Aplikimit për nën-projektin “renovimi i shtëpive private për familje apo individët e cenueshëm” në kuadër të Projektit “banimi social adekuat” në Kosovë.**

1.2. Verifikimi i gjendjes ekonomike për familjet/individët që kanë shprehur interesin për renovim / rindërtim të shtëpive private, duke përfshirë shqyrtimin e Formës së kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm (shtojca 1 dhe shtojca 2), si dhe verifikimin dhe vlerësimin në terren të familjes dhe gjendjes aktuale-fizike të shtëpisë për renovim / rindërtim.

1.3. Komisioni Vlerësues është i detyruar të zbatojë kriteret e përcaktuara të poentimit dhe radhës së përparësisë të bashkëngjitura si shtojcë në këtë vendim (shtojca 4).

1.4. Mosdiskriminimi gjatë përzgjedhjes së Përfituesve Përfundimtarë duhet të jetë një parim themelor në fillimin dhe implementimin e Projektit përmes nën-projektit për Renovim/Rindërtim të Shtëpive Private, me prioritizim të familjeve më të cenueshme si kategori të varfra apo ekstrem të varfra, me marrjen e masave specifike për të siguruar respektimin e këtij parimi.

1.5. Konsideratat gjinore duhet të përfshihen nga fillimi, hartimin dhe zbatimin e projektit, me konsideratë të veçantë në: dhënien përparësi ekonomike familjare të udhëhequra nga gratë dhe grave beqare, dhe veçanërisht grave viktimat të dhunës seksuale ose në familje, në përzgjedhjen

e Përfituesve Përfundimtarë në Komunë, si dhe kërkesa që dokumentet e qëndrimit (vërtetimi i pronësisë) të jenë (vetëm ose gjithashtu) në emër të grave.

1.6. Pas përfundimit të verifikimit dhe vlerësimit, Komisioni Vlerësues përgatitë raportin përfundimtarë dhe dorëzon Formularin e Aplikimit me dokumentacionin përcjellës pranë Njësitit të Menaxhimit të Projektit (NjMP) të Banimit Social Adekuat në kuadër të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) dhe vetëm pas miratimit të kërkesave dhe buxhetit nga NjMP/MMPHI, Komisioni Vlerësues është i obliguar të njoftojë familjen/individin për rezultatet.

Neni 4 **Zbatimi i Vendimit**

1. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatimi i tij është i obligueshëm për të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi *shfuqizohet* Vendimi Sh.02.Nr.23103 i datës 22.08.2025.

Vendimi t'i dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Anëtarëve të Komisionit; dhe
- QSHQ-Arkivit.



The image shows a circular official stamp of the Municipality of Kamenice, Republic of Kosovo. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E KOSOVES", "KOMUNA E KAMENICES", "02 KRYETARI I KOMUNES", and "KODINOP". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in blue ink. Below the signature, the name "Kadri Rahimaj" is printed in bold black text. Above the signature, the title "Kryetari i Komunës" is printed in bold black text.

Këtij vendimi i bashkëngjiten:

1. Shtojca Nr.1: **Forma e Kërkesës - Formulari i Shprehjes së Interesit për Përfituesit për Rinovim/Rindërtim të Shtëpive Private;**
2. Shtojca Nr.2: **Lista Kontrolluese mbi kushtet e banimit në shtëpitë private, bazuar në inspektimin vizual nga Komuna;**
3. Shtojca Nr.3: **Dokumentet që duhet të dorëzohen nga Aplikuesi;**
4. Shtojca Nr.4: **Tabela e Vlerësimit sipas Kritereve të Përparësisë.**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E KAMENICËS
OPŠTINE KAMENICA / MUNICIPALITY OF KAMENICA



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTTARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA

Sh. 02 Nr. 24432
U. Br.
Nr. i faq. 1 Data: 03/09
Br. str. Datum: 2025

Nr. 279/2025

Datë: 03.09.2025

Në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe të Shpalljes Publike Nr.02/22280 të datës 14.08.2025 për pozitën : Dizajner/e Grafik në Zyren për Informim. Kryetari i Komunës merr këtë:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS**

1. Formohet Komisioni për për zgjedhjen e kandidatëve për pozitën : Dizajner/e Grafik në Zyren për Informim në këtë përbërje:
 - 1.1.Valdete Berisha Murina, Kryesuese;
 - 1.2 Rijad Rahimaj, anëtarë;
 - 1.3. Liridon Rexhepaj, anëtarë;
2. Komisioni do t'i vlerësojë të gjithë kandidatët pas intervistimit, rekomandon kandidatët që kanë treguar rezultate më të mira gjatë intervistimit
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi t'i dergohet:

- Zyrës së Kryetarit
- Zyrës së Personelit
- Anëtarëve të Komisionit



Kadri RAHIMAJ

Kryetar i Komunës së Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.326, datë:03.09.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxheres së kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxheres së kontratës

1. Caktohet menaxherja e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxheres së kontratës me titull: **"LOT – 5 - Transporti i nxënësve në SHFMU "Metush Krasniqi" në Roganë"**, me numër të kontratës **KM653-25-5782-2-1-1**, si në vijim:
 - 1.1. **Znj. Belgizare Kryeziu** (Drejtoreshë e Shkollës "Metush Krasniqi", Roganë), **CAKTOHET** menaxhere e kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. **Z. Shefik Rudhani** (Drejtorja Komunale e Arsimit), **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxheres së kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxherja e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxheres së kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe manualët për përdorim të modulit për menaxhim të kontratës.
3. Të dërgohet raport i rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- znj. Belgizare Kryeziu (Drejtoreshë e Shkollës "Metush Krasniqi", Roganë);
- z. Shefik Rudhani (Drejtorja Komunale e Arsimit); dhe
- QSHQ-arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.324, datë:03.09.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 70 pika b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"LOT – 3 – Transporti i nxënësve me aftësi të kufizuara në SHFMU "Fan S. Noli" në Kamenicë"**, me numër të kontratës **KM653-25-5782-2-1-1**, si në vijim:

1.1. Z. Bajram Selmani (Sekretar i Shkollës "Fan S.Noli", Kamenicë), **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

1.2 Z. Shefik Rudhani (Drejtorja Komunale e Arsimit), **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Bajram Selmani (Sekretar i Shkollës "Fan S.Noli", Kamenicë);
- z. Shefik Rudhani (Drejtorja Komunale e Arsimit); dhe
- QSHQ-arkivi.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.325, datë:03.09.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxheres së kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxheres së kontratës

1. Caktohet menaxherja e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxheres së kontratës me titull: **"LOT – 4 - Transporti i nxënësve të fshatit Novosellë që mësojnë në SHFMU "Metush Krasniqi" në Roganë"**, me numër të kontratës **KM653-25-5782-2-1-1**, si në vijim:
 - 1.1. **Znj. Belgizare Kryeziu** (Drejtoreshë e Shkollës "Metush Krasniqi", Roganë), **CAKTOHET** menaxhere e kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2 **Z. Shefik Rudhani** (Drejtorja Komunale e Arsimit), **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxheres së kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxherja e kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxheres së kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe manualët për përdorim të modulit për menaxhim të kontratës.
3. Të dërgohet raport i rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- znj. Belgizare Kryeziu (Drejtoreshë e Shkollës "Metush Krasniqi", Roganë);
- z. Shefik Rudhani (Drejtorja Komunale e Arsimit); dhe
- QSHQ-arkivit.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.327, datë:03.09.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **“LOT – 6 – Transporti i nxënësve në SHFMU “17 Shkurti” në fshatin Muçivërc”,** me numër të kontratës **KM653-25-5782-2-1-1**, si në vijim:

1.1. Z. Agim Shkodra (Drejtor i Shkollës "Sejdi Kryeziu", Roganë), **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

1.2 Z. Shefik Rudhani (Drejtorja Komunale e Arsimit), **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualët për Përdorim të Modulit për Menaxhim të Kontratës.
3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Agim Shkodra (Drejtor i Shkollës "Sejdi Kryeziu", Roganë);
- z. Shefik Rudhani (Drejtorja Komunale e Arsimit); dhe
- QSHQ-arkivi.

Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.328, datë:03.09.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

VENDIM

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **"LOT – 7 – Transporti i nxënësve në SHFMU "17 Shkurti" në fshatin Muçivërc",** me numër të kontratës **KM653-25-5782-2-1-1**, si në vijim:

1.1. Z. Basri Spahiu (Drejtor i Shkollës "17 Shkurti", Muçivërc), **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

1.2 Z. Shefik Rudhani (Drejtoria Komunale e Arsimit), **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, të datës 20.10.2022, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Të dërgoj raport të rregullt për procesin e përmbushjes së kontratës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

T'i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës për Informim;
- Zyrës së Prokurimit;
- z. Basri Spahiu (Drejtor i Shkollës "17 Shkurti", Muçivërc);
- z. Shefik Rudhani (Drejtoria Komunale e Arsimit); dhe
- QSHQ-arkivi.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Sh.02.Nr.329, datë:03.09.2025

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022, për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b) të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës së Kamenicës, merr këtë:

VENDIM

